



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 698/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 17.10.2018 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

“Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e operatorit ekonomik “Cara” sh.p.k në procedurën e prokurimit me Nr. Ref-74956-06-14-2018, me objekt: “Rikonstruksion kopshti Hasan Koçi” dhe “Rikonstruksion cerdhja nr.4”, me fond limit 24.999.000 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 18.07.2018, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.”

Ankimues:

“Cara” sh.p.k
Rruga “Hasim Vokshi”, Nd.14, H.6, Ap.15, Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Durrës
Lagja nr.1, Sheshi “Liria”, Durrës

Subjekte të Interesuara:

“Ina” sh.p.k
Rruga Besim Imami, Myslym Shyri, Prapa karburantit, Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjo i relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I


Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.



II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 18.06.2018 është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit me Nr. Ref-74956-06-14-2018, me objekt: “*Rikonstruktion kopshti Hasan Koçi*” dhe “*Rikonstruktion cerdhja nr.4*”, me fond limit 24.999.000 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 18.07.2018, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

II.2. Në datën 27.07.2018 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht për klasifikimin përfundimtar të ofertave dhe ofertuesit e skualifikuar si më poshtë:

1. “Cara” sh.p.k	16.083.270 lekë, skualifikuar
2. “Ina” sh.p.k	16.789.979 lekë, kualifikuar
3. “Shendelli” sh.p.k	17.628.183 lekë, skualifikuar
4. “Tea D” sh.p.k	17.769.864 lekë, skualifikuar
5. “Arkonstudio” sh.p.k	17.943.095 lekë, kualifikuar
6. “Murati” + “Boshnjaku B”sh.p.k	18.383.958 lekë, kualifikuar
7. “Eurondërimi 2000” sh.p.k	18.502.828 lekë, kualifikuar

8. “Dajti Park 2007” sh.p.k	18.510.674 lekë, skualifikuar
9. “Rajli Ndertim” sh.p.k	18.742.616 lekë, kualifikuar
10. “Liqeni VII” sh.p.k	19.312.414 lekë, kualifikuar
11. “Sark” sh.p.k	19.692.146 lekë, skualifikuar
12. “Beqiri” sh.p.k	19.808.281 lekë, skualifikuar
13. “Jogi” sh.p.k	21.098.973 lekë, skualifikuar
14. “Elda-VI” sh.p.k	s’ka paraqitur ofertë.

Operatori ekonomik “Cara” sh.p.k rezulton i skualifikuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave me argumentin:

“Ofertuesi CARA me vlere te ofertes 16’083’270 lekë, nuk ka përmbushur kërkesat për kualifikim te kerkuara ne dokumentat e tenderit e konkretisht: - Per kriteret e vecanta te kualifikimit, ne piken 2.3 “Për kapacitetin teknik”, germa g; Liçensa profesionale e shoqërisë lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

- Ne Licencen profesionale te Shoqërise CARA, regjistruar ne regjistrin themeltar qe nga data: 05.05.2016, drejtuesi teknik, inxhinieri i ndertimit A. Sh, mungon ne te gjitha listepagesat per kontributet e sigurimeve shoqerore dhe shendetesore te paraqitura nga ky ofertues e konkretisht ne muajt: Janar 2017 deri Dhjetor 2017 dhe Janar 2018 deri Maj 2018. KVO vendos qe ofertuesi te mos kualifikohet.”

II.3. Në datën 03.08.2018 operatori ekonomik “Cara” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar skualifikimin e tij në procedurën e prokurimit. Konkretisht pretendohet:

“[...] Moskualifikimi nuk qëndron sepse në licensën e shoqërisë ne disponojmë inxhinier ndërtimi që është në të gjitha listëpagesat për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të paraqitura nga ana jonë. Shiko të gjitha dokumentacionin e hedhur në sistemin elektronik të tenderimit [...].”

II.4. Nëpërmjet shkresës nr. 5989/2 prot., datë 07.08.2018, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimesit si vijon:

“[...]Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës gjykon se mospërfshirja në listpagesë qoftë edhe e njërit prej drejtuesve teknik të shoqërisë përbën kusht skualifikues. Theksojmë se në dokumentat e tenderit, në shtojcën 12, pika 2.3/1 thuhet se ofertuesi duhet të paraqesë:

List pagesat sipas formularëve standarde për sigurimet, për muajin e fundit që i takojnë pagesat me ditën e hapjes së ofertave, ku numri i punonjësve të jetë minimumi 35 persona (përfshirë dhe numrin e punonjësve të stafit sipas pikës “h”). Dokumenta të konfirmuara nga insitacioni përkatës.

Në rastin konkret nuk është përfshirë në listpagesë njëri prej drejtuesve teknikë të shoqërisë, sipas licencës lëshuar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës. Gjykojmë jo të drejtë qëndrimin tuaj në ankesë se ju dispononi më shumë se një inxhinier ndërtimi. Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka të drejtë të përzgjedhë drejtuesit teknik që përfshin apo heq nga listpagesa, qoftë edhe në varësi të llojit të punimeve që kryhen nga një autoritet kontraktor. Në respektim të ligjshmërisë së

procesit administrativ të licencimit të subjekteve, marrëdhënieve të punës dhe investimit me fonde shtetërore në të mirë të publikut, komisioni vlerëson se, për sa kohë subjekti është i pajisur me licencë nga një organ publik ku figuron lista me drejtuesit teknik, këta drejtues duhet të jenë në marrëdhënie pune pranë subjektit, në respektim të vetë licencës.

Sa më sipër, nga ofertuesi detyrimisht duhet të ishin përfshirë në listpagesë të gjithë drejtuesit teknik të deklaruar në licencën e shoqërisë NZ 2175/19, me numër rendor 002781, regjistruar në regjistrin themeltar që nga data 05.05.2016. Mospërfshirja qoftë edhe e njërit prej tyre përbën kusht skualifikues, njëkohësisht dhe shkelje fiskale. Një subjekt që kërkon të përfitojë nga fondet publike për investime duhet të jetë korrekt dhe në përputhje me aktet ligjore në fuqi [...].

II.5. Në datën 16.08.2018 operatori ekonomik “Cara” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke parashtruar të njëjtat pretendime si edhe në autoritetin kontraktor.

II.6. Në datën 30.08.2018 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1407/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 14918/1 prot., datë 28.08.2018, me objekt: “Dërgim informacioni”, bashkëngjitur informacioni e dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesës.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me arsyen skualifikimit të operatorit ekonomik “Cara” sh.p.k se: *Ofertuesi CARA me vlere te ofertes 16'083'270 lekë, nuk ka përmbushur kërkesat për kualifikim te kerkuara ne dokumentat e tenderit e konkretisht: - Per kriteret e vecanta te kualifikimit, ne piken 2.3 “Për kapacitetin teknik”, germa g; Liçensa profesionale e shoqërisë lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës: - Ne Licencen profesionale te Shoqerise CARA, regjistruar ne regjistrin themeltar qe nga data: 05.05.2016, drejtuesi teknik, inxhinieri i ndertimit Asllan Shutina, mungon ne te gjitha listepagesat per kontributet e sigurimeve shoqerore dhe shendetesore te paraqitura nga ky ofertues e konkretisht ne muajt: Janar 2017 deri Dhjetor 2017 dhe Janar 2018 deri Maj 2018. KVO vendos qe ofertuesi te mos kualifikohet”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.1.1. Në shtojcën 12 « Kriteret e vecanta të kualifikimit », «Kapaciteti teknik», pika 2.3, gërma « g » dhe « h » e dokumentave të tenderit nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri kualifikues si më poshtë:

g. Liçensa profesionale e shoqërisë lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

NP-1 A - Punime germimi ne toke

NP-3 A – Rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile dhe industriale, veshje fasada

NP-7 A -Ujesjelles, gazsjelles,vajsjelles,vepra kullimi e vaditje

NS-1 A- Punime per prishjen e ndertimeve,

NS-2 A- Impiante hidro-sanitare , kuzhina, lavanteri, mirembajtja e tyre

NS-4 A- Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami.

NS-12A- Impiante teknologjike, termike dhe te kondicionimit

NS-14A- Impiante te brendshem, elektrike, telefoni, radiotelefoni, TV

h. "Stafi teknik i shoqërisë të ketë në përbërje:

➤ Inxhinier Ndertimi 1 punonjes

➤ Inxhinier Elektrik 1 punonjes

➤ Inxhinier Hidroteknik 1 punonjes

➤ Mjek 1 punonjes

➤ Teknik Ndertimi 1 punonjes

➤ Punetore te specializuar ndertimi

Hidraulik 1 punonjes

Elektracist 1 punonjes

Muarator 1 punonjes

Pllakashtrues 1 punonjes

➤ Punetore te specializuar ne ndertim me certifikate per punime ne lartesi dhe perdorimin e skelave 2 punonjes

➤ Punëtore ndertimi te thjeshte 24 punonjes.

Më pas, në pikën 1, po këtu, është parashikuar:

"List pagesat sipas formulareve standarte për sigurimet, për muajin e fundit që i takojnë pagesat me datën e hapjes së ofertës, ku numëri i punonjësve të jetë minimumi 35 persona (përfshirë dhe numrin e punonjësve të stafit sipas pikës "h") Dokumenta te konfirmuara nga institucioni përkatës".

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të shoqërisë "Cara" sh.p.k, konstatohet se për përmbushjen e kriterit si më sipër cituar, lidhur me inxhinierin e ndërtimit, kjo shoqëri ka paraqitur dokumentacionin si vijon:

1. Kontratë pune të lidhur ne datën 22.03.2018 midis punëdhënësit "Cara" sh.p.k dhe punëmarrësit E. H, me kohë punësimi pa afat.
2. Licencë (profesionale) Z42....., e lëshuar nga Ministria e Punëve Publike, Transporteve dhe Telekomunikacionit, në emër të zotit E.H.
3. Diplomë lëshuar nga Universiteti Politeknik i Tiranës sipas të cilës studenti E.H filloi studimet në ... dhe mbaroi në vitin ...kursin e plotë të Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit.
4. Licenca e shoqërisë "Cara" sh.p.k, në të cilën figuron edhe z.E.H si një nga drejtuesit teknik të shoqërisë.
5. CV e z.E.H

6. *Librezë pune.*
7. *Dëshmi kualifikimi E.H.*
8. *Kartë identiteti e z. E.H.*
9. *Listpagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi për periudhën tatimore janar 2017-maj 2018, për shoqërinë “Cara” sh.p.k, ku punonjësi me inicialet E.H figuron në të gjitha këto listpagesa, pra gjatë gjithë periudhës në fjalë.*
10. *Deklaratë e shoqërisë “Cara” sh.p.k sipas së cilës, ndërmjet të tjerave, z.E.H, Inxhinier Ndërtimi, caktohet drejtues teknik i zbatimit të punimeve të objektit për të cilin konkurron (subjekti Cara) dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës në objekt...*
11. *Vërtetim datë 25.06.2018 lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Dibër ku jepet informacion për numrin e punonjësve të shoqërisë “Cara” sh.p.k. Sipas kësaj shkrese, për muajin maj 2018 shoqëria Cara sh.p.k ka 44 punonjës.*

III.1.3. Në nenin 46, pika 1/b, të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”*

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*

III.1.4. Në nenin 55, pika 2 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet *2.Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit.*

III.1.5. Ndërsa në nenin 26, pika 5 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, përcaktohet se: *“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

III.1.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kapaciteteve të kërkuara në dokumentat e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor, do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit në respekt të nenit 66 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 i ndryshuar. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi. KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.7. Bazuar në sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nga ana e autoritetit kontraktor, në dokumentat e procedurës së prokurimit me Nr. Ref-74956-06-14-2018, me objekt: *“Rikonstruksion kopshti Hasan Koçi”* dhe *“Rikonstruksion cerdhja nr.4”*, me fond limit 24.999.000 lekë pa tvsh, është përcaktuar se kushti që në stafin teknik të shoqërisë të ketë në përbërje (përveç të tjerëve) edhe 1 punonjës Inxhinier Ndertimi, vërtetuar kjo me List pagesën e muajit të fundit që i takojnë pagesat me datën e hapjes së ofertës. Numri i punonjësve të jetë minimumi 35 persona (përfshirë dhe numrin e punonjësve të stafit sipas pikës “h”, pra përfshirë edhe inxhinierin e ndërtimit, kërkesa të cilat përbëjnë detyrim ligjor për tu plotësuar nga ofertuesit e kualifikuar.

Në rastin konkret rezulton se operatori ekonomik “Cara” sh.p.k, në përmbushje të kërkesës së sipërcituar të autoritetit kontraktor, ka paraqitur vërtetim lëshuar nga Administrata Tatimore Dibër, sipas të cilës rezulton se kjo shoqëri ka 44 punonjës të siguruar në muajin maj, dhe sipas listpagesës së punonjësve të muajit maj, rezulton se kjo shoqëri disponon një inxhinier ndërtimi në stafin e saj, vërtetuar edhe me dokumentacion shtesë provues si licenca, diplome, cv, kontratë pune etj.

Sa më sipër, referuar kriterit të vendosur nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi që stafi teknik i shoqërisë të ketë në përbërje një inxhinier ndërtimi, KPP gjykon se operatori ekonomik “Cara” sh.p.k e ka përmbushur kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor, në dokumentat e tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi. Arsyeja e skualifikimit nga ana e autoritetit kontraktor me pretendimin se drejtuesi teknik, inxhinieri i ndërtimit A.Sh , mungon në të gjitha listepagesat për kontributet e sigurimeve shoqerore dhe shendetesore të paraqitura nga ky ofertues e konkretisht në muajt: Janar 2017 deri Dhjetor 2017 dhe Janar 2018 deri Maj 2018, bie në kundërshtim me nenin 55, pika 2 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pasi autoriteti kontraktor nuk ka kërkuar në dokumentet e tenderit që operatori ekonomik pjesëmarrës në procedurë duhet të ketë të listpagesa të gjithë drejtuesit teknik sipas licensës së shoqërisë.

Komisioni i Prokurimit Publik rithekson se, autoritetet kontraktore duhet të përcaktojnë dokumentat konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e kriterëve, si dhe nuk duhet të përdorin kritere që nuk janë të përcaktuara në dokumentat e tenderit të procedurës përkatëse të prokurimit. Në mënyrë eksplicite ligji për prokurimin publik parashikon se vlerësimi i ofertave duhet bërë vetëm në përputhje me kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentet e procedurës përkatëse. Vlerësimi i ofertave referuar kriterëve të tjera të kualifikimit të cilat në asnjë rast nuk janë parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit jo vetëm që është në kundërshtim me nenin 55 pika 2 e LPP-së, si më sipër cituar, por cënon gjithashtu parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit, parashikuar nga neni 2 i *lex specialis*, atë të barazisë në trajtimin e kërkesave dhe detyrimeve që i ngarkohen ofertuesve.

Përsa i përket konstatimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave se *për sa kohë subjekti është i pajisur me licencë nga një organ publik ku figuron lista me drejtuesit teknik, këta drejtues duhet të jenë në marrëdhënie pune pranë subjektit, në respektim të vetë licensës*, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se licensimi i shoqërive private kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe është detyrim i organeve kompetente të kryejnë monitorimin dhe ndjekjen e zbatimit të legjislacionit përkatës lidhur me drejtuesit teknikë, të cilët figurojnë në licencën e subjektit privat.

Pretendimi i ankimuesit qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Cara” sh.p.k për procedurën e prokurimit me me Nr. Ref-74956-06-14-2018, me objekt: “*Rikonstruksion kopshti Hasan Koçi*” dhe “*Rikonstruksion cerdhja nr.4*”, me fond limit 24.999.000 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 18.07.2018, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për skualifikimin e operatorit ekonomik “Cara” sh.p.k, dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si mësipër, duke e kualifikuar këtë ofertues.
3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Cara” sh.p.k.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Nr. 1407 Protokoli,
Datë 16.08.2018



KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha